



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura III**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,  
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione  
Mbledhja nr. 09  
Prishtinë, më 27. 04. 2010, ora 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Persona të Pagjetur dhe Peticione

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismet Beqiri – kryetar, Nerxhivane Dauti, Hajredin Hyseni, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Danush Ademi, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati.

**Mungoi:** Ibrahim Selmanaj.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Mimoza Ahmetaj - deputete, Xhemajl Ahmeti – OHCHR, Shqipe Krasniqi – ABGJ, Leonora Selmani – ABGJ, Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit dhe Elita Vokshi – OSBE.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Visar Krasniqi.

**Mbledhjen e drejtoi Ismet Beqiri.**

**Kryetari** konstatoi se në bazë të Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës ishin plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 6. 4. 2010,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të grupit të punës lidhur me Programin e Qeverisë së Republikës Kosovës për barazi gjinore,
4. Shqyrtimi i amendamenteve të dhëna në Projektligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje, të paraqitura nga grupi i punës,
5. Të ndryshme

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23. 03. 2010**

*Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 6. 4. 2010, pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të grupit të punës lidhur me Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për barazi gjinore**

**Kryetari** – I përshëndeti të pranishmit dhe mbikëqyrësit e punës së Komisionit. Shtoi se Komisioni e ka ngarkuar grupin e punës, në përbërje: Shpresa Murati, Drita Maliqi, Danush Ademi dhe deputetja Mimoza Ahmetaj, ta shqyrtojë Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për barazi gjinore, për promovimin dhe për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të drejtave të njeriut. Kjo nismë ka ardhur në bazë të mocionit të deputetes Mimoza Ahmetaj. Kryesia e Kuvendit e ka ngarkuar Komisionin ta shqyrtojë Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për barazi gjinore. Kërkoj që sa më parë Kryesisë t'i procedohet Programi bashkë me rekomandimet, në mënyrë që të kërkohet nga Kuvendi miratimi i tij. Programi duhet t'i përgjigjet dinamikës së evoluimit, t'i përfshijë ndryshimet e reja, që e përcaktojnë ecurinë e zhvillimeve në favor të grupeve shoqërore dhe t'u përgjigjet qëllimeve të integritetit evropian dhe synimit të mijëvjeçarit.

**Mimoza Ahmetaj** - E falënderoi grupin e punës, me të cilin kishte bashkëpunim të mirë në nxjerrjen e këtyre rekomandimeve. E kemi shqyrtuar këtë Program dhe jemi munduar t'i bëjmë disa plotësime, të cilat duhet t'i bashkëngjiten Programit, që të jetë më i begatshëm.

**Drita Maliqi** - U pajtua me parafralësen dhe shtoi se grupi i punës i ka propozuar disa rekomandime. Si anëtare e grupit i ka ngritur disa çështje të tjera, por për disa nuk ishin pajtuar dhe Komisionit i procedohen këto rekomandime:

- Në kuadër të pikës për shëndetësi, në Programin për barazi gjinore të përfshihen PAP-testi, mamografia dhe ultrazëri i gjirit, falas, në të gjitha institucionet shëndetësore publike.
- Në Program të përfshihet çështja e sigurisë,
- Në bazë të Ligjit për barazi gjinore, si mekanizëm kryesor i përmirësimit dhe i ngritjes së barazisë gjinore në nivel lokal, të hapen zyra për barazi gjinore,
- Komitetet komunale për barazi gjinore duhet të jenë të veçanta, të funksionalizohen dhe të veprojnë si të pavarura.

**Shqipe Krasniqi – ABGJ** - Duke u ndërlidhur me Programin për barazi gjinore, tha se po bëhen dy vjet që është miratuar në Qeveri ky Program, që më në fund do të procedohet në Kuvend. E njoftoi Komisionin për punën e ABGJ-së lidhur me trajnimin e disa zyrtarëve në ministri dhe në komuna. U pajtua me rekomandimet e grupit të punës. Diskutoi edhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me Programin.

**Shpresa Murati** - Programin e barazisë gjinore e vlerësoi lart dhe u pajtua që pikat shtesë t'i bashkëngjiten dhe t'i procedohet Kuvendit për miratim.

Komisioni pas diskutimeve konstruktive lidhur me Programin për barazi gjinore njëzëri e nxori këtë

### **P e r f u n d i m**

Komisioni i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës ta miratojë Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për barazi gjinore nr. 07/17, të datës 24. 04. 2008, me këto plotësime:

- Në kuadër të pikës për shëndetësi në Programin për barazi gjinore të përfshihen PAP-testi, mamografia dhe ultrazëri i gjirit, falas, në të gjitha institucionet shëndetësore publike,
- Në Program të përfshihet çështja e sigurisë,
- Në bazë të Ligjit për barazi gjinore, si mekanizëm kryesor i përmirësimit dhe i ngritjes së barazisë gjinore në nivel lokal, të hapen zyra për barazi gjinore,
- Komitetet komunale për barazi gjinore duhet të jenë të veçanta, të funksionalizohen dhe të veprojnë si të pavarura.

#### **4. Shqyrtimi i amendamenteve të dhëna në Projektligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje, të paraqitura nga grupi i punës**

**Nerxhivane Dauti** - Grupi i punës ia paraqiti Komisionit propozimamendamentet e dhëna në Projektligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje. Në përgjithësi e njoftoi Komisionin për shqyrtimin e amendamenteve të Grupit Joformal të Grave dhe tha se ishte kontestues neni 27 i Projektligjit për mbrojtjen nga dhuna. Pas një debati, Komisioni i miratoi ato, *ashtu siç kishte propozuar grupi punës.*

*Komisioni njëzëri i miratoi amendamentet dhe e nxori këtë*

### **P e r f u n d i m**

*Komisioni i miratoi amendamentet e dhëna në Projektligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe propozoi që raporti me amendamente t'i procedohet Kuvendit për miratim.*

**Drita Maliqi** – Pati vërejtje për amendamentet e Grupi Joformal të Grave dhe theksoi se ato kanë vlerë, prandaj nuk është dashur të refuzohen.

Ismet Beqiri - Tha se grupi i punës i ka pasur amendamentet në shqyrtim. Nëse e konsideroni të arsyeshme mund t'ia procedoni Kuvendit për miratim, por pa përkrahje të Komisionit.

Raporti me amendamentet e miratuara do t'i bashkëngjitet procesverbalit.

## 5. Të ndryshme

**Nerxhivane Dauti** - Lidhur me ankesën e Millorad Smiliqit nga Lipjani tha se Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk po e zbaton Vendimin e KPMK-së nr. 1692/09 të datës 1. 9. 2009. I propozoi Komisionit t'i rekomandojë Ministrisë për Komunitete dhe Kthim t'i marrë të gjitha veprimet administrative në funksion të zbatimit të Vendimit të KPMK-së dhe e njoftoi Komisionin për veprimet që janë marrë.

Mbledhja përfundoi në orën 14:20

Kryetari i Komisionit

---

Ismet Beqiri